

lajmi.net

# Vritet një 30-vjeçar në Ferizaj

LAJME

LAJMI I FUNDIT

lajmi.net

Më afër lexuesit.

28/05/2022 09:38

f

🐦

🔗

Një vrasje e rëndë ka ndoddhur sot në orët e para të mëngjesit në Ferizaj.

Kjo është bërë e ditur me anë të një komunikate për media nga Policia e Kosovës, shkruan lajmi.net.

Policia ka treguar se viktima e këtij rasti është një 30-vjeçar.

### Komunikata e plotë e Policisë:

Me daten 28.05.2022 rreth orës 00:53, Policia Rajonale e Ferizajt ka pranuar një informacion se, në rrugën “Rexhep Bislimi” tek marketi “Euro Market” në Ferizaj kishte të shtëna me armë zjarri. Patrullat e policisë menjëherë ju kanë përgjigjur kësaj thirrje dhe kanë dalë në vendin e ngjarjes, më pas edhe hetuesit dhe krim teknikët e Sektorit Rajonal të Hetimeve nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj.

Nga hetimet e para, dyshohet se personi me inicialet Q.J ( M/K) i moshës 30 vjeçar, ka shtënë me armë zjarri në personin tjetër me inicialet G. H (M/K) i moshës 30 vjeçar, i cili si pasojë e plagëve nga arma e zjarrit ka ndërruar jetë në vendin e ngjarjes, kjo e konfirmuar nga mjekët e spitalit të Ferizajt.

Afër vendit të ngjarjes, një njësi e policisë me automjet zyrtar civil dhe pjesëtarë të policisë me rroba civile, në detyrë zyrtare, kanë vërjetur të dyshuarin me armë zjarri në dorë dhe kanë filluar fillimisht me urdhëra verbal “ ndal policia” që të ndalet, por i dyshuari nuk ka përfillur urdhërat e policisë. I dyshuari me pistoletë në dorë, dyshohet që, në një moment i kthehet zyrtarëve policor dhe njeri zyrtar policor, për ta shmangur rrezikun e drejtpërdrejt ndaj tij, kolegut të tij dhe të tjerëve përreth, e përdor armën e zjarrit zyrtare , me një shkrepte në drejtim të të dyshuarit . I dyshuari, menjëherë dërgohet për ndihmë mjekësore në Qendrën Emegjente në Ferizaj, e më pas për tretman të mëtutjeshëm mjekësor dërgohet në në QKUK – Prishtinë dhe sipas mjekëve, gjendja shëndetësore e tij është stabile dhe jashtë rrezikut për jetën, ndërsa policia i ka marrë masat për sigurinë e tij.

Lidhur me rastin është njoftuar Prokurori kujdestar nga Prokuroria Themelore e Ferizajt dhe IPK-ja të cilët kanë dalë në vendin e ngjarjes.

Me vendim të Prokurit lidhur me veprimet e zyrtarit policor do të marrin vendim Prokurori i rastit së bashku me IPK-në,ndërsa për veprimet tjera hetimore lidhur me vrasjen Sektori Rajonal i Hetimeve nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj.


Si provë materiale nga vendi i ngjarjes është konfiskuar dy armë zjarri ( pistoleta) dhe shtatë ( 7) gëzhoja.

Gjithashtu , me vendim të Prokurorit, trupi i pa jetë i viktimës është dërguar në Instituton e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë për obduksion, ndërsa ndaj të dyshuarit Q.J është lëshuar vendimi për ndalim për 48 orë.

Sektori Rajonal i Hetimeve nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj , nën autorizim të Prokurorit i ka marr të gjitha veprimet e nevojshme Në vendin e ngjarjes, ka mbledhur prova materiale dhe deklarative se si ka ndodhur rasti.

Për informata tjera do të njohroheni me kohë. **/Lajmi.net/**

## Artikuj të ngjashëm



May 28, 2022

Ambasada amerikane për riatdhësimin e kosovarëve nga Siria: Kosova, shembull për...




May 28, 2022

Vizita e parë dhe e fundit e Nishanit si president ishte në Kosovë




May 28, 2022

Analistët: Nëse s’ka përparim në dialog, ka izolim të Kosovës dhe...



May 28, 2022

Sulmuan me shufra pronarin e barnatores “Rexall”, prokuroria parashtron kërkesë për...



May 28, 2022

“The Economist”: A është lija e majmunëve “Covid2”?



May 28, 2022

Ambasadori gjerman: Xhafer Deva ishte kolaboracionist nazist